

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagimi - SafeJournalists: Presioni dhe përpjekja për të diskredituar gazetaren nga ish-drejtoresha e SH ISH ngre shqetësime serioze
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918901/safejournalists-presioni-dhe-perpjekja-per-te-diskredituar-gazetaren-nga-ish-drejtoresha-e-shish-ngre-shqetesime-serioze/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 13:05:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 12:48:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1a539bbc18d06b78973dcda9fbe35e2fb8002b76ac8f4f122c061b8890883144
TEKSTI	eb50213c7998e3a3ec1f13ff905e84c42fe0c8fed4aa4610e7d66c5026e10982
PAMJA	d106db3d31d6415ebfd752493b5f3e5b9e821a65316b18e6a146b97acbd27363

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d1b24a2810c26a1a9915f9f09d1eafc413106f150bc051463b4aee9b229f5064
E MËPARSHMJA	aee6221239ad3107540b3de4cbbf1062715928c8d83d21c382081b0b83b57c5e
RRËNJA MERKLE	8fce1880916715b76e8ac15ae32c1334413ec3860fcf4a9bbb4d291304df9a8a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d1b24a2810c26a1a9915f9f09d1eafc413106f150bc051463b4aee9b229f5064>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës

më të lexuarat

VIDEO-‘Janë 3 orë përgjime’/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Protesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vivojnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënMashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartëVIDEO-‘Hajde të tregoj unë ty’/
Përplasja me Ramën në avion, i ri: Më
kapi për qafe dhe më tha ‘të zhduk’Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë‘S’ka normalitet për situatën ku
ndodhemi’, Këlliçi: Të gjithë e kanë
pranuar skandalin e Roni Yefet, Rama
jo!

SafeJournalists: Presioni dhe përpjekja për të diskredituar gazetaren nga ish-drejtoresha e SHISH ngre shqetësime serioze

14:48, 24/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Rrjeti SafeJournalists shpreh shqetësim serioz për frikësimin publik dhe përpjekjen për të diskredituar gazetaren investigative të News24, Klodiana Lala, nga Vlora Hyseni, ish-Drejtoreshë e Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), më 24 shtator 2026.

Incidenti ndodhi jashtë Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO), ku Hyseni u paraqit në lidhje me një hetim në zhvillim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Hyseni ndodhet në arrest shtëpie në kuadër të një procedimi që buron nga një hetim më i gjerë mbi një grup të dyshuar kriminal, i cili dyshohet për manipulimin e tenderëve publikë në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Në ditët para incidentit, Lala kishte raportuar mbi këtë çështje dhe mbi komunikimet e pretenduara të Hysenit me Ergys Agasin, biznesmen dhe një nga figurat qendrore të hetimit për AKSHI-n.

Ndërsa Lala e pyeste Hysenin për këto komunikime, Hyseni iu përgjigj: “Klodi, si kalon ti në takime me agjentët serbë në dhomat e hotelit Rogner?” Akuza u bë publikisht, në prani të gazetarëve të tjerë dhe kamerave.

SafeJournalists e konsideron incidentin veçanërisht serioz, pasi Lala po ushtronte detyrën e saj profesionale dhe po pyeste një ish-zyrtarë të lartë shtetërorë për një çështje me interes të qartë publik, kur vëmendja u zhvendos drejt vetë gazetares. Lidhja publike e një gazetareshe investigative me shërbime të huaja të inteligjencës mund të dëmtojë besueshmërinë e saj dhe ta ekspozojë ndaj ngacmimeve, kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke nasur parasvish fushatat e mënashme denigruese dhe ngacmimet ndaj lalës në

lidhje me raportimin e saj mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Pozicioni i Hysenit e bën deklaratën edhe më serioze. Pretendimi i saj se ka dijeni se me kë është takuar Lala dhe ku janë zhvilluar këto takime ngre shqetësime për përdorimin e mundshëm të informacionit të privilegjuar të siguruar përmes strukturave shtetërore të inteligjencës. Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta për privatësinë e gazetarëve, mundësinë e mbikëqyrjes dhe konfidencialitetin e kontakteve dhe burimeve të tyre profesionale.

Deklarata ngre gjithashtu pikëpyetje nëse informacione mbi lëvizjet apo kontaktet profesionale të Lalës janë aksesuar ose përdorur nga strukturat e inteligjencës. Shqetësime të tilla mund të dekurajojnë burimet që të komunikojnë me gazetarët dhe të pengojnë raportimin investigativ mbi çështje sensitive.

Incidenti ngre gjithashtu shqetësime për keqpërdorimin e mundshëm të autoritetit ose informacionit të inteligjencës. Përdorimi i informacionit të siguruar përmes strukturave të inteligjencës për të frikësuar ose diskredituar një gazetare do të cenonte konfidencialitetin e burimeve dhe raportimin e pavarur.

SafeJournalists i bën thirrje Vlorë Hysenit të tërheqë menjëherë akuzën ndaj Klodiana Lalës dhe të përmbahet nga deklaratat të mëtejshme që mund ta frikësojnë, diskreditojnë ose rrezikojnë gazetaren.

Rrjeti i bën thirrje SHISH-it dhe institucioneve kompetente të mbikëqyrjes dhe drejtësisë të verifikojnë nëse ndonjë informacion i mbajtur apo i siguruar përmes strukturave shtetërore të inteligjencës mbi Klodiana Lalën, lëvizjet, komunikimet apo kontaktet e saj profesionale është aksesuar, bërë publik apo përdorur në lidhje me këtë incident, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e plotë të burimeve konfidenciale dhe komunikimeve profesionale të gazetares.

Autoritetet shqiptare duhet gjithashtu të vlerësojnë çdo rritje të rrezikut për sigurinë e Lalës pas kësaj akuze dhe të reagojnë menjëherë ndaj çdo kërcënimi, ngacmimi apo forme tjetër të shënjestrimit.

Organizata thekson se gazetarët duhet të jenë në gjendje të hetojnë dhe të kërkojnë llogari nga zyrtarë aktualë dhe ish-zyrtarë të fuqishëm pa iu nënshtruar frikësimit, akuzave për mungesë besnikërie apo insinuatave se kontaktet e tyre profesionale konfidenciale po monitorohen. Sjellje të tilla rrezikojnë të krijojnë një efekt frikësues jo vetëm për gazetaren e shënjestruar, por edhe për komunitetin më të gjerë të medias dhe për burimet e gatshme të japin informacion në interes të publikut.

Rrjeti SafeJournalists do të vazhdojë ta ndjekë rastin dhe do të informojë aktorët përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë për zhvillimet e mëtejshme.

Prishtinë – Shkup – Sarajevë – Zagreb – Beograd – Podgoricë – Tiranë, 24 shtator 2026

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Shoqata e Gazetarëve BH

Shoqata Kroate e Gazetarëve

Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë



Klodiana Lala

‘Garancia e plotë’ e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlorë Hysenit

‘Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar’, Blushi: ‘KAYO’ e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

Nata e 6 në shesh kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së/ Protestës i bashkohet edhe Përparim Rama

Lexo edhe:



SYRI TV/ Skandali SHISH, qytetarët rrethojnë Kuvendin: Ku e keni Vlorën



SYRI TV/ Skandali SHISH, tensione në kuvend, deputet e PD bllokojnë foltoren e Kuvendit



UGSH dënon shoqërimin e gazetares Peca dhe deklaratat ndaj Klodiana Lalës: Klimë shqetësuese për lirinë e medias

TË NGJASHME



Berisha: PD do të përdorë të gjitha mjetet kundër kësaj qeverie dhe po përgatitet për të dhënë përgjigjet e merituara



Berisha: Vlora Hyseni shantazhoi gazetaren! Buzhala, Baton Haxhiu dhe Albatros Rexha kanë shkelur ligjin



Berisha: Hyseni ka zbatuar çdo porosi të Ramës! Ergys Agasi është mafiozi më i rrezikshëm i Europës



VIDEO/ Deputetja që i servilosej Ramës blen këpucë online në seancë parlamentare



Revolta kundër Ramës/ Policia shoqëron 17 protestues



VIDEO/ Shteti në ditë të zeza, Vullnet Sinaj 'shijon' videot me Enver Hoxhën në Kuvend



Boçi: Vlora Hyseni nuk ra nga qielli, Rama duhet të vijë këtu me dorëheqjen në dorë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net